



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës Rahovec, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.08.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për këmbimin e pronës komunale me pronën e institucionit qendror

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, Nr. 02/1069/23, i datës 8.8.2023 dhe jepet PËLQIMI për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur *Suteska*, zona kadastrale Retijë, parcela me numër P-71510069-01505-0, sipas Certifikatës së pronësisë pronë e Komuna Rahovec, me sipërfaqe prej 650m² (gjashtëqind e pesëdhjetë metra katror), e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 279608m² (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetë metra katror), I JEPET në posedim P.S.H.E KOSOVES K.K.RAHOVEC UJRAT, ndërsa parcela, sipas Certifikatës së pronësisë P-71510056-01987-0, në posedim të P.S.H.E KOSOVES K.K.RAHOVEC UJRAT, me sipërfaqe prej 650m² (gjashtëqind e pesëdhjetë metra katror) e cila ndahet nga pjesa e përgjithshme prej 13505m² (trembëdhjetë mijë e pesëqind e pesë metra katror), I JEPET Komunës Rahovec, në emër të këmbimit.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është për interes publik, përkatësisht për funksionalizimin e zonës ekonomike në ZK- Opterushë për qytetarët e komunës Rahovec dhe më gjerë.
3. OBLIGOHET Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që t'i zhvillojë procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Vlerësimi i pronës komunale dhe i pronës së institucionit qendror të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.

5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar me përmbajtjen e të dhënave të pronave të këmbyera, si dhe emrin e pronarit të institucionit qendror me të cilin është bërë këmbimi.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës Rahovec, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.124/23
Më datë:30.08.2023

